



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 198 Prot

Tiranë, më 24 / 1 /2021

REKOMANDIM

Nr. 08 , datë 24 / 1 /2021

PËR PROGRAMIN E TRANSPARENCËS
SË AUTORITETIT PUBLIK “BASHKIA SARANDË”

Në mbështetje të neneve 6, 7 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, shkronjës f) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”), Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka kryer monitorimin on-line në faqen zyrtare:

<https://bashkiasarande.gov.al/programi-i-transparences/>, të Autoritetit Publik “Bashkia Sarandë” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Bazuar në nenin 4 të LDI, Autoriteti Publik ka detyrimin të vendosë në zbatim programin institucional të transparencës, sipas Urdhrit nr. 211, datë 10.09.2018 “Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore” të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në të cilin përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publike pa kërkesë.

Ky program, vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti Publik ndërton dhe rrit transparencën në veprimtarinë e tij institucionale, nëpërmjet përditësimit dhe pasurimit të vazhdueshëm të tij, në referencë edhe të pikës 2 të nenit 5 të LDI.

Në lidhje me monitorimin e kryer, nga Drejtoria për të Drejtën e Informimit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Komisioneri"), konstaton se Autoriteti Publik, në menunë kryesore të faqes zyrtare ka të publikuar ikonën "Transparenca" në brendësi të së cilës janë vendosur fushat e programit të transparencës të ndara në ikona të veçanta, në përputhje me modelin e miratuar me Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore" të Komisionerit. Në këto fusha është ndërlidhur informacioni, i cili është pjesë përbërëse e programit të transparencës si dhe një pjesë tjetër gjendet në faqen kryesore. Gjithashtu, kanë mbetur pa u publikuar shumë kategori informacioni që bëhet publik pa kërkesë.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se pavarësisht se një pjesë e informacionit publik pa kërkesë është publikuar në faqen zyrtare, Autoriteti Publik duhet t'i përmbahet programit model të transparencës të miratuar nga Komisioneri me Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore", sipas gjetjeve të pasqyruara në lidhjen nr. 1 të këtij rekomandimi.

Detyrimi për bërjen transparente të veprimtarisë së tyre, njësive të vetëqeverisjes vendore i'u lind gjithashtu edhe në zbatim të Kreut VI, të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar. Konkretisht në nenin 15 të ligjit të sipërcituar "Transparenca e veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes vendore", parashikohet se: "*1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre. 2. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike...*".

Në mbështetje të neneve 6 dhe 7 të LDI dhe shkronjës f) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, nga monitorimi i kryer,

REKOMANDOJ :

1. Autoriteti Publik/Bashkia Sarandë të pasqyrojë/ndërlidhë, në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t'u bërë publike në përputhje me nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore" të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas lidhjes nr. 1 të këtij rekomandimi.
2. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij rekomandimi, brenda një afati 90 (nëntëdhjetë) ditor nga momenti i marrjes dijeni.

3. Në rast mospërbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 18, 19 dhe 20 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 28. 1 .2021

KOMISIONERI

Besnik Dervishi



1. Organizimi dhe funksionimi i bashkisë:

1.1 Organizimi administrativo-territorial, misioni dhe funksionet

1.1.1 Ndarja administrative territoriale

- Njësitë administrative dhe nën-ndarjet e tyre

1.1.2 Të drejtat, përgjegjësitë dhe misionin e bashkisë

1.1.3 Funksionet përfshin bërjen publike

- në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike;
- në fushën e shërbimeve sociale;
- në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese;
- në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit;
- në fushën e zhvillimit ekonomik vendor;
- në fushën e sigurisë publike; Funksionet dhe kompetencat e deleguara

The screenshot displays the official website of the Municipality of Sarandë. The page features a header with the municipality's logo and a navigation menu. The main content area is titled "Organizimi dhe funksionimi i Bashkisë" and is organized into sections: "1 - ORGANIZIMI ADMINISTRATIVO - TERRITORIAL, MISIONI DHE FUNKSIONET", "1.1 - NDARJA ADMINISTRATIVO - TERRITORIALE", "1.2 - TË DREJTAT, PËRGJEGJËSITË DHE MISIONI", and "1.3 - FUNKSIONET". A sidebar menu on the right lists various services and documents. At the bottom, there is a banner for "VENDIMËT E KESHILLIT BASHKËRIK SARANDE".

Organizimi dhe funksionimi i Bashkisë.

Organizimi dhe funksionimi i Bashkisë

1 - ORGANIZIMI ADMINISTRATIVO - TERRITORIAL, MISIONI DHE FUNKSIONET

1.1 - NDARJA ADMINISTRATIVO - TERRITORIALE

- Njësitë administrative dhe nën-ndarjet e tyre

1.2 - TË DREJTAT, PËRGJEGJËSITË DHE MISIONI

- Kliko këtu për të hapur dokumentin e plotë

1.3 - FUNKSIONET



- Funksionet në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike;
- Funksionet në fushën e shërbimeve sociale;
- Funksionet në fushën e kulturës, sportit, dhe shërbimeve argëtuese;
- Funksionet në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- Funksionet në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit;

Kreu

- NËSHILLI BASHKËRIK
- BASHKËRIKIA SARANDE ADMINISTRATIVE
- URBANISTIKA
- SHËRBIME
- DUKORËTI DHE TARGAT
- KONSULCIMI PUBLIK
- KËRKESA / FORMULARË
- SARANDE TURIZEM
- HAPJA E BASHKISË
- NËNDITJE

ANËTARËT KESHILLIT



VENDIMËT E KESHILLIT BASHKËRIK SARANDE




Informacioni është i publikuar pjesërisht në faqen zyrtare por nuk është i ndërlidhur me programin e transparencës.

1.2 Organi përfaqësues i Bashkisë - Këshilli Bashkiak: (përbërja, strukturat,detyrat dhe kompetencat). Përfshin bërjen publike të:

- Këshilli Bashkiak - Përbërja dhe Struktura (Anëtarët,Kryetari i Këshillit, Sekretari i Këshillit, Komisionet,Grupet e këshilltarëve);
- Detyrat dhe kompetencat;
- Rregullorja e KB;






Informacioni është i publikuar në faqen zyrtare dhe në programin e transparencës.

1.3 Organi përfaqësues i Bashkisë - Këshilli bashkiak (procesi i vendimmarrjes). Përfshin bërjen publike të:

- Kalendarit të mbledhjeve të KB;
- Njoftimet për mbledhjen e KB;
- Rendin e ditës së mbledhjes së KB;
- Projekt-vendimet në proces shqyrtimi nga KB;
- Procesverbalet e mbledhjeve të KB;
- Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat me karakter normativ;




Informacioni është i publikuar pjesërisht në faqen zyrtare por nuk është i ndërlidhur me programin e transparencës. Mungon informacioni në lidhje me:

- Projekt-vendimet në proces shqyrtimi nga KB (formati i plotë);
- Procesverbalet e mbledhjeve të KB;

1.4 Organi ekzekutiv (Kryetari i Bashkisë). Përfshin bërjen publike të:

- Procedurat e zgjedhjes;
- Detyrat dhe kompetencat;
- Të dhënat për arsimin, kualifikimet, paga e kryetarit dhe deklarimi i pasurisë;
- Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat me karakter normativ;
- Orari i pritjes së qytetarëve;
- Adresa postare/ elektronike;




Informacioni është i publikuar pjesërisht në faqen zyrtare por nuk është i ndërlidhur me programin e transparencës. Mungon informacioni si:

- Detyrat dhe kompetencat;
- ... paga e kryetarit dhe deklarimi i pasurisë;
- Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat me karakter normativ;
- Orari i pritjes së qytetarëve;
- Adresa postare/ elektronike;

1.5 Administrata e Bashkisë. Përfshirë bërjen publike:

- Struktura organizative dhe numri i punonjëve;
- Rregullore për organizimin dhe funksionimin e administratës;
- Struktura e pagave;
- Orari i punës së bashkisë, njësive administrative dhe njësive të varësisë;
- Detyrat e administratës dhe njësisë administrative;
- Organizimi dhe funksionimi i njësive në varësi;
- Njoftime për vende të lira pune dhe procedurat e rekrutimit;
- Adresa postare ose elektronike e zyrave të bashkisë/njësive administrative/njësive të varësisë;
- Drejtuesit e zyrave, njësive administrative dhe njësive të varësisë;

- Raportet e auditimit të brendshëm të ushtruar në bashki;
- Çdo raport përfundimtar të kontrollit të jashtëm (KLSH) të ushtruar në bashki;
- Planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm;




Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.

1.7 Kërkesa, ankesa, sinjalizime dhe vërejtje që lidhen me:

- Procedura për të bërë kërkesë ankesë, vërejtje dhe sinjalizime organeve të bashkisë;
- Rregullore e brendshme për procedurën e shqyrtimit, hetimit administrativ, sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit;
- Njësinë përgjegjëse që regjistron, heton administrativisht dhe shqyrton sinjalizimet;

- Adresa postare/elektronike për depozitimin e kërkesave, ankesave, sinjalizimeve dhe vërejtjeve;
- Afatet dhe mënyrat e kthimit të përgjigjeve në lidhje me kërkesat, ankesat, vërejtjet;




Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.

1.8 Statistikat vendore Kalendarri i publikimit të statistikave

- Statistika vendore me të dhëna kyce të bashkisë sipas fushave kryesore dhe të ndara sipas gjinisë
- Strukturën përgjegjëse në bashki për mbledhjen dhe përpunimin e statistikave





Informacioni është i publikuar pjesërisht në faqen zyrtare por nuk është i ndërlidhur me programin e transparencës.


2. Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko – financiare:


2.1 Kalendar i programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor

Informacioni nuk është i publikuar pjesërisht në programin e transparencës.

2.2 Paketa fiskale (taksa dhe tarifa). Përfshin bërjen publike të:

- Baza e taksave dhe e tarifave;
- Niveli i taksave;
- Përfshirje dhe lehtësime të subjekteve të caktuara;
- Afatet e pagesave;
- Gjoha dhe kamatvonesa të aplikueshme;





Informacioni është i publikuar në faqen zyrtare por nuk është i ndërlidhur me programin e transparencës.

2.3 Plani Strategjik i Zhvillimit të Bashkisë:

- Politikat për zhvillimin e qëndrueshëm në një afat kohor jo më pak se 5 vite;
- Synimet kryesore për çdo fushë përgjegjëse;
- Veprimet që duhen ndërmarrë duke parashikuar edhe kostot përkatëse;
- Burimet e financimit;

Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.


2.4 Programi Buxhetor Afatmesëm vendor. Përfshin bërjen publike të:

- Dokumenti i parë i PBA-së;
- Dokumenti i rishikuar i PBA-së;
- Dokumenti i plotë i PBA-së;

Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.

2.5 Buxheti përfshin bërjen publike të:

- Buxheti vjetor së bashku me dokumentacionin shoqërues (12 dokumente);
- Treguesit financiarë;
- Numri i punonjësve buxhetor për çdo njësi shpenzuese;
- Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik;



Informacioni është i publikuar pjesërisht në faqen zyrtare por nuk është i ndërlidhur me programin e transparencës. Mungon regjistri i parashikimeve të prokurimit publik.

2.6 Zbatimi i buxhetit

- Raporti mujor (pas datës 30 pill të cdo viti buxhetor) të përmbledhur mbi ecurinë e realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve (8 raporte)

Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.

2.7 Monitorimi dhe mbikëqyrja e buxhetit

- Raporte të monitorimit të zbatimit të buxhetit (jo më pak se tre raporte 4-mujore)
- Raporti vjetori i konsoliduar i zbatimit të buxhetit (raporti i performancës vjetore dhe pasqyra financiare vjetore)
- Raportit të performancës vjetore
- Pasqyrave financiare vjetore (dokumentacionin bazë dhe shoqërues)
- Informacioni mbi zbatimin dhe monitorimin e kontratave (punë publike, mallra, shërbime)
- Regjistri i realizimeve të procedurave të prokurimit public



Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës. Kur klikon në fushën “transparenca dhe llogaridhënia ekonomike – financiare”, del një informacion i përgjithshëm mbi programin e transparencës.

2.8 Vështirësitë Financiare

- Plani për daljen nga situata e vështirë financiare

Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.

2.9 Shitja ose dhënia me qera e pronave dhe asetëve

- Asete dhe prona të ofruara për shitje ose dhënie me qera
- Kriteret që duhen plotësuar

Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.

2.10 Donacione:


- Emri i donatorit;
- Shuma e donacionit;
- Qëllimi i donacionit;

Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.

3. Për kërkesat për informacion

3.1 Të dhënat e koordinatorit për të drejtën e Informimit (Emër, kontaktet dhe kompetencat). Përfshin bërjen publike të:


- Emrit mbiemrit të Koordinatorit;
- Adresa postare / elektronike;
- Detyra dhe kompetenca;
- Orari punës;
- Adrese postare / elektronike për depozitimin e kërkesave;



Informacioni është i publikuar pjesërisht në faqen zyrtare por nuk është i publikuar në programin e transparencës. Mungojnë detyrat dhe kompetencat.

3.2 Standarde dhe procedura që duhen ndjekur për të bërë kërkesë për informim dhe ankesës. Përfshin bërjen publike të:


- Procedurës që duhet ndjekur për të bërë një kërkesë për informacion;
- Adresë postare/electronike për dërgimin e kërkesës për informim;
- Modeli standard i kërkesës;
- Afatet për marrjen e përgjigjes;
- Procedura që duhet ndjekur për të bërë një ankesë për mos dhënie informacioni;
- Adresë postare/electronike për dërgimin e ankesës për mos dhënie informacioni;



Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.

3.3 Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve. Përfshin bërjen publike të:

- Të gjitha kërkesat për informim;
- Informacionet e dhëna në përgjigje të kërkesave për informim;
- Përditësimi i regjistrit;



Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.

3.4 Informacion i dhënë më parë:



Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.

3.5 Trajtimi i kërkesave për informacion


- Procedura e regjistrimit të kërkesës në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve;
- Afatet e trajtimit të kërkesës nga ana e administratës së bashkisë;
- Mënyrat e dhënies së informacionit;



Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.

3.6 Kufizimi i së drejtës së informimit:

- Rastet e kufizimit të së drejtës për informim;



Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.

3.7 Tarifa për dhënien e informacionit nëse ka:


- Niveli i tarifës;
- Rregulla për mënyrën e kryerjes së pagesës;
- Subjekte që përftojnë informacion falas;



Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.

3.8 Informacionet dhe dokumentet që kërkohen shpesh:

- Gjithë informacioneve dhe dokumenteve të kërkuara më shpesh nga publiku me kërkesë për informim;



Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.


4. Mbi shërbimet që ofron bashkia:

4.1 Shërbimet Përfshin bërjen publike të shërbimeve publike që ofron Bashkia sipas fushave të përcaktuara ligji nr. 139/2015:

- "Shërbimet në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike"
- "Shërbimet në fushën e shërbimeve sociale"
- "Shërbimet në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese"
- Shërbimet në fushën e mbrojtjes së mjedisit
- "Shërbimet në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit"
- "Shërbimet në fushën e zhvillimit ekonomik vendor"
- "Shërbimet në fushën e sigurisë publike"
- "Shërbimet në fushën e funksioneve dhe kompetencave të deleguara"

Për çdo shërbim (por pa u kufizuar) informacion përshkrues mbi:

- Instrument për administrimin e shërbimit
- Sistemin e administratës të performancës së shërbimit bazuar mbi standardet
- Sistemin e treguesve, përfshirë edhe aspektin gjinor për matjen e performancës
- Strukturën përgjegjëse për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës së shërbimit, përfshirë edhe aspektin gjinor




Informacioni është i publikuar pjesërisht në faqen zyrtare por nuk është i ndërlidhur me programin e transparencës.

4.2 Shërbimet administrative Përfshin bërjen publike të shërbimeve publike që ofron Bashkia sipas fushave të përcaktuara ligji nr. 139/2015:

- Shërbimet administrative në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike;
- Shërbimet administrative në fushën e shërbimeve sociale;
- Shërbimet administrative në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese;
- Shërbimet administrative në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- Shërbimet administrative në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit;
- Shërbimet administrative t në fushën e zhvillimit ekonomik vendor;
- Shërbimet administrative në fushën e sigurisë publike;
- Shërbimet administrative në fushën e funksioneve dhe kompetencave të deleguara;

Për çdo shërbim (por pa u kufizuar) informacion përshkrues mbi:


- Strukturat përgjegjëse për ofrimin e shërbimit;
- adresën postare/elektronike të strukturave/njësive/sportelevë që ofrojnë shërbime administrative;
- procedurat që duhen ndjekur për të përfituar shërbime administrative;
- Oraret e punës së strukturave/njësive/sportelevë që ofrojnë shërbime administrative;
- Tarifat për shërbimet administrative;
- Rregullat për mënyrën e kryerjes së pagesës;
- Subjektet që përjashtohen nga tarifat;



Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.

4.3 Kontratat publike përfshin bërjen publike të:

- Objektit të kontratës publike;
- Numrit të referencës së procedurës/ kontratës;
- Llojit të procedurës;
- Termave dhe kushteve të kontratës;
- Kohëzgjatjes së kontratës;
- Vlerës së kontratës;
- Dhënave të autoritetit kontraktor;
- Dhënave të kontraktorit/nënktraktorit;
- Treguesve për matjen e përmbushjes së kontratës;
- Strukturave publike përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e kontratës;
- Procedurave që duhet ndjekur për të bërë një ankimim;
- Raporteve të kontrollit, monitorimit dhe auditimit mbi zbatimin e kontratës;



Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.

4.4 E drejta e ankesës dhe vërejtjes në lidhje me shërbimet:

- Procedurave për të bërë ankesa apo vërejtje në lidhje me shërbimet;
- Adresës postare/elektronike për depozitimin e ankesave apo vërejtjeve;



Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.

5. Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore. I organizuar (jo i detyrueshëm) sipas fushave:

- Fusha e organizimit dhe funksionimit të bashkisë;
- Fusha e veprimtarisë ekonomiko-financiare;
- Fusha e transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare;
- Fusha e infrastrukturës dhe shërbimeve publike;
- Fusha e shërbimeve sociale;

- Fusha e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese;
- Fusha e mbrojtjes së mjedisit;
- Fusha e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit;
- Fusha e zhvillimit ekonomik vendor;
- Fusha e sigurisë publike;
- Fusha e funksioneve dhe kompetencave të deleguara.

Çdo fushë duhet të përmbajë:

- Aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse;
- dokumentet politike kombëtare përkatëse;
- Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e këshillit të bashkisë me karakter normativ;
- Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e kryetarit të bashkisë me karakter normativ;
- Dokumentet politike vendore;




Informacioni është i publikuar në faqen zyrtare por nuk është i ndërlidhur me programin e transparencës.

6. Pjesëmarrja qytetare në vendim-marrje:

6.1 Të dhënat e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik:


- Emër mbiemër të koordinatorit
- Adresën postare/ elektronike të tij
- Orarin e punës



Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.

6.2 Plani vjetor për procesin e vendimmarrjes me pjesëmarrje:


- Aktet që do të konsultohen;
- Mënyra e konsultimit;
- Afatet;
- Strukturat përgjegjëse;



Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.

6.3 Dispozitat e brendshme rregullatore për këshillimin me publikun. Përfshin bërjen publike:


- Procedurave, afateve dhe mënyrat e organizimit për çdo formë/lloj konsultimi;
- Strukturat përgjegjëse për aktet e detyrueshme për konsultim;



Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.

6.4 Akte për të cilët është e detyrueshme zhvillimi i konsultimit publik. Përfshin bërjen publike të:


- Listës së akteve për të cilët është e detyrueshme zhvillimi i konsultimit publik;



Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.

6.5 Njoftimi për nismën vendimmarrëse me pjesëmarrje;

- Projektaktit, relacionin shpjegues dhe dokumentave shoqërues të tij;
- Arsyeve të nevojshme për nxjerrjen e projektaktit, si dhe ndikimi që ai do të ketë;
- Afatit, vendit dhe mënyrën me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre;
- Adresën e kontaktit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik të bashkisë ose të strukturës përgjegjëse për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projektaktin;
- Vendin dhe datën e organizimit të takimit publik në rastet kur bashkia vendos për organizimin e tij;



Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.

6.6 Procedura e marrjes dhe shqyrtimit të komenteve dhe rekomandimeve:


- Adresën postare/ elektronike për dërgimin e komenteve dhe rekomandimeve;
- Afatin për dërgimin e komenteve dhe rekomandimeve;
- Mënyrën e mbajtjes së procesverbalit dhe regjistrimit të takimit publik për takimet publike;
- Mënyrën e trajtimit të komenteve dhe rekomandimeve;
- Mënyrën e dhënies së arsyeve për mospranimin komenteve dhe rekomandimeve;



Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.

6.7 Procedurat që duhen ndjekur për të bërë një ankim në lidhje me konsultimin publik. Përfshin bërjen publike të:


- Subjektet ku mund të bëhet ankesa (Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale Këshilli i Bashkisë, Kryetari i Bashkisë);
- Adresën postare/ elektronike për dërgimin e ankesës;
- Procedurat për të bërë një ankesë në lidhje me këshillimin me publikun;
- Struktura përgjegjëse në nivel bashkie që regjistron dhe shqyrton ankesën;



Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.

6.8 Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes:

- Numrit të akteve të miratuara nga organet e bashkisë me konsultim publik gjatë një viti;
- Numrin e përgjithshëm të komenteve dhe rekomandimeve të marra nga palët e interesuara;
- Numrin e rekomandimeve dhe komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes;
- Numrin e takimeve publike të organizuara;



Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.

6.9 Iniciativa qytetare. Përfshin bërjen publike:

- Mënyrës dhe formës së paraqitjes së iniciativës qytetare;
- Procedurave të shqyrtimit dhe e miratimit të iniciativës qytetare;
- Adresës postare/ elektronike për depozitimin e iniciativës qytetare;
- Mënyrat dhe afatet e kthimit të përgjigjeve për mos miratimin e iniciativës qytetare;




Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.

7. Informacion tjetër:

7.1 Bashkia në proceset e integritit evropian:

- Të dhënave për projektet, nismat dhe veprimtarisë e bashkisë në kuadrin e integritit në BE;



Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.

7.2 Bashkia dhe shoqëria civile. Në tërësi të dhëna për grupet e interesit:


- Të dhëna për OJF, përfaqësuesit e medias, biznesi;
- Shërbimet që ofrohen nga organizata të ndryshme;
- Nismat advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqëria civile;
- Nismat advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqëria civile;



Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.

7.3 Raporte, studime dhe vlerësime mbi zbatimin e Programit të transparencës:

- Raporte, studime dhe vlerësime mbi zbatimin e programit të transparencës;



Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.

7.4 Strukturat komunitare. Përfshin bërjen publike të:

- Të dhëna për strukturat komunitare në fshat;
- Të dhëna për strukturat komunitare në qytet;
- Detyrat, kompetencat dhe kompetencat e strukturave komunitare;
- Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e këshillave komunitare;



Informacioni nuk është i publikuar në programin e transparencës.